V E N D I M
Nr.512, datë 26.10.1993

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.479, DATË 16.9.1993 "PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.276, DATË 30.6.1992 "PËR IMPORTIMIN, PRITJEN, ADMINISTRIMIN DHE SHPËRNDARJEN E ARTIKUJVE USHQIMORË KRYESORË"

Me propozimin e Ministrisë së Tregtisë dhe të Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

Në fund të pikës 2 të kapitullit II të shtohet një paragraf tjetër me këtë përmbajtje:

"Ministria e Tregtisë dhe e Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit mund të përjashtojnë shitjen nëpërmjet ankandit të mallrave ushqimore ndërmarrjeve shtetërore në rastet:

a) Kur furnizohen institucione buxhetore dhe NTT Studentëve, që konsumojnë sasi të mëdha të këtyre mallrave.

b) Kur mekanizmi i tregut të lirë nuk arrin të sigurojë dërgimin e mallrave kryesore ushqimore në zona të ndryshme e për pasojë krijohen në to probleme sociale".

2. Pika 9 të ndryshohet për datën e hyrjes në fuqi të vendimit nga 1.10.1993 në 1.11.1993.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi